

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE TIRANE  
Nr. 4007 Rep Nr. 257 Kol



**KONTRATE SHITJE**  
**KUOTASH TE KAPITALIT THEMELOR TE SHOQERISE "BI-DRILLING"**

**Sh.P.K.**

Ne Tirane, sot ne date 24.11.2000, para meje noterit Fatmir Zaloshnja, bulevardi "Deshmoret e Kombit" 62/1 u paraqiten personalisht:

**SHITESI: Renis Tershana**, I biri I Agimit, lindur ne Tirane ne 23.09.1971, banues po aty, rruga "Sh. Ishmi" nr. 17, madhor, me zotesi te plate juridike e per te vepruar, identifikuar me leter njoftimin personal Nr. N.F. 489270.

**BLERESI Ervin Lera**, I biri I Nasit, lindur ne Tirane ne 02.04.1973, banues po aty rruga "F. Xhakjo" Pall. 67/1, Shk. 5, Ap. 50, madhor, me zotesi te plate juridike e per te vepruar, identifikuar me leter njoftimin personal Nr. Q.H. 342240.

**Palet kane rene dakort te lidhin kete kontrate shitje me kushtet si me poshte:**

Renis Tershana, eshte ortak i vetem dhe administrator I shoqerise "R&T" Tirane dhe si I tille disponon 100% te kuotave te kapitalit themelor te saj. Kete fakt ai e verteton me vendimin e gjyqetarit te vetem te gjykates se rrethit Tirane Nr. 12540 date 20.12.1996.

Ne keto kushte Shitesi Renis Tershana, si pronar I 100% te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise "R&T" Sh.P.K. konforme ligjit 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerit Tregetare" dhe te nenit 6 te statutit te shoqerise "R & T"- 50% te kuotave te kapitalit themeltar se bashku me te drejtat reale mbi to ne vlere prej 1.300.000 (Njemilion e treqindmije) leke ja shete blesesit Ervin Lera.

Bleresi Ervin Lera eshte dakort te bleje kuotat ne vleren e mesiperme nga Renis Tershana. Ai jashte kesaj zyre I ka paguar shitesit Renis Tershana vleren e mesiperme. Shitesi garanton blesesin se kuotat qe ai shet ne mesen 50% jane te lire nga c' do barre e Hipoteke dhe blesesi mund ti disponoje ato menjeher pas lidhjes se kesaj kontrate. Per detyrime te prapambetura si dhe per ato qe mund te lindin me vone nga veprimtaria e shitesit para lidhjes se kesaj kontrate, pergjigjet ai vet.

Me nenshkrimin e kesaj kontrate shitesi Renis Tershana zhvishet nga pronesia e 50% te kapitalit themeltar (Duke perfshire ne kete 50% edhe ate qe eshte vene gjate aktivitetit te shoqerise) dhe te drejtave reale mbi te dhe bashkpronar ne masen 50% te kuotave dhe te drejtave reale te Sh.P.K. "R & T" behet blesesi Ervin Lera, I cili do te veproje si ortak I perbashket me ortakun e administratorin e kesaj shoqerie Renis Tershana.

Sa siper eshte nje kontrate shitje kuotash, e redaktuar ne tre kopjo te njellojta, me vullnetin e lire e te plate te paleve, ndaj nenshkruhet rregullisht prej tyre, c'ka e vertetoj me nenshkrimin tim.

SHITESI  
Renis Tershana

BLERESI  
Ervin Lera

NOTERI  
Fatmir ZALOSHINJA



PULLE TAKSE



100  
LEKE

R. SHQIPERISE